


# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NËXTUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#110



## GRUPI I PUNES/ Informacion i standardizuar për Shqipërinë në platformat ndërkombëtare



Një grup ndërinstitucional pune do të vlerësojë dhe standardizojë informacioni për Shqipërinë dhe shqiptarët në platformat ndërkombëtare digjitale.

Sipas vendimit më të fundit të qeverisë, ky grup pune i përbërë nga përfaqësues të disa institucioneve do të identifikojë platformat ndërkombëtare digjitale, të cilat ofrojnë informacione për Shqipërinë dhe shqiptarët. Gjithashtu do të vlerësojë vërtetësinë dhe saktësinë e informacioneve, në këto platforma si dhe do të realizojë dorëzimin përfundimtar të informacionit zyrtar pranë platformave.

Sipas vendimit ky grup do të mbledhet të paktën tre herë në vit ose jashtë radhe me kërkesë të kryetarit të tij. Ky grup do të përgatitë raportim vjetor me shkrim për veprimtarinë e tij që do të dërgohet kryeministrit dhe të gjitha ministrive dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).



## "Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

## AKD organizon takimin e parë të juristëve në Diasporë

Të hënë, më datë 7 Qershor ora 10:00, Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Drejtësisë do të zhvillohet "Takimi i Juristëve në Diasporë".

Prezantimi i rrjetit të profesionistëve, angazhimi i profesionistëve në fushën e drejtësisë në Diasporë dhe ndërveprimi i tyre me juristët në Shqipëri është një ndër qëllimet kryesore të këtij eventi.

Aktiviteti do të zhvillohet në "Plazza Hotel", me të pranishëm fizikisht dhe online.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

## PUBLIKIMI/ AKD nxjerr buletinin e parë për ecurinë e Strategjisë së Diasporës



Publikohet numri i parë (Mars 2021) i Buletinit për ecurinë e zbatimit të masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ndjek zbatimin e masave të Planit të Veprimit nga institucionet përkatëse dhe informon çdo tre muaj publikun mbi ecurinë dhe procesin e zbatimit të masave të Planit të Veprimit, përmes publikimit të Buletinit. Ky dokument është buletini i parë për strategjinë e re, e cila është vazhdim i veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 e cila e ka përmbyllur ciklin e saj në 31 dhjetor 2020.


Publikimi i këtij dokumenti synon informimin e qytetarëve të interesuar brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e politikave e masave shtetërore për Diasporën. Gjithashtu, Buletini informon anëtarët e strukturave vendimmarrëse lidhur me politikën, sukseset e arritura dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të reformës shtetërore për Diasporën.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjeve si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## "DIGI DIASPORA"/ Takimi i dytë, në fokus krijimi i rrjetit profesional

"Digi Diaspora 2 – Meetup #2", një takim virtual me qëllimin e ofrimit të njohurive në fushën e IT-së, mbajti takimin e saj të dytë duke angazhuar profesionistë të kualifikuar nga Diaspora shqiptare. Synimi kryesor i eventit ishte forcimi i kapaciteteve të bizneseve lokale dhe komunitetit digjital, si dhe rrjetëzimi profesional. Pjesëmarrësit nga vende të ndryshme të botës, si SHBA, Kanada, Zvicra etj. ndanë eksperiencat dhe njohuritë e tyre profesionale në fushën e teknologjisë, duke dhënë një panoramë të situatës së industrisë informatike.



U theksua zhvillimi i dukshëm i kapaciteteve të profesionistëve shqiptarë, të cilët janë bërë dhe faktor në investimin dhe krijimin e sipërmarrjeve të reja, si brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë organizim në platformën ZOOM, iu'u dha mundësia të gjithë të interesuarve të bënin pyetje rreth temës së teknologjisë, duke u thelluar tek avantazhet dhe diasavantazhet e ushtrimit të profesionit në Diasporë.



## Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

## QBD/ "Tregime të moçme shqiptare", falas online botimi dygjuhësh shqip-anglisht



Qendra e Botimeve për Diasporë sjell falas online përkthimin e rrëfimeve nga letërsia shqipe për fëmijë, me autor Mitrush Kutelin. Përrallat e "Tregimeve të moçme shqiptare" vijnë në botimin dygjuhësh shqip-anglisht, përkthyer nga Ron Berisha.

"Tregime të moçme shqiptare" është pjesë e projektit të botimeve dygjuhëshe, ndërmarrë nga QBD-ja. Dhjetë tregime të përzgjedhura nga vëllimi "Tregime të moçme shqiptare", me autor Mitrush Kutelin, vijnë të përkthyer në pesë gjuhë: anglisht, italisht, greqisht, gjermanisht dhe frëngjisht.

Këto tregime dhe përralla do të shërbejnë për zgjerimin e njohurive, marrjen e informacionit dhe kultivimin e dijeve të nxënësve në Diasporë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën amtare. Ky botim shërben edhe si tekst ndihmës për shkollat në Diasporë, me qëllim thellimin e njohurive të tyre mbi gjuhën shqipe.



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

## QSPA/ "Vështrim krahasues mbi tekstilet Arbëreshe", takim me antropologun Onuzi


"Vështrim krahasues mbi tekstilet e Arbëreshëve të Italisë së Jugut dhe ato shqiptare", ishte tema e takimit të organizuar nga "Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët" ditën e sotme me antropologun Afërdita Onuzi.



Onuzi ka ndarë sot me Drejtoreshën dhe studiuesit e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, të dhëna nga studimet e saj krahasuese mbi proceset e realizimit të tekstileve nga Arbëreshët e Italisë së jugut dhe shqiptarët.

Me një përvojë të shtrirë në 50 vite punë si etnologue, profesoreshë Onuzi shpjegoi për të pranishmit lidhjet ndërmjet mjeteve e proceseve të punës, terminologjisë dhe aktiviteteve sociale që realizohen nga të dyja palët gjatë realizimit të tekstileve, e që janë provat e gjalla të vazhdimësisë kulturore shqiptare tek arbëreshët.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: këtu Play store: këtu

## QSPA/ Një konferencë shkencore për personalitetin e gjuhësisë shqiptare Emil Lafa



Drejtoresha e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët Diana Kastrati ka marrë pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Profesor Emil Lafa, personalitet i shquar i gjuhësisë shqiptare" të organizuar nga Universiteti i Vlorës.

Znj. Kastrati në hapje të konferencës mbajti një fjalë përshëndetëse në nderim të kontributit akademik të profesorit Emil Lafa, i cili është njëerësh edhe drejtor i revistës shkencore "Continuum", botim i QSPA.

Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) gjithashtu ka dhuruar sot botimet e vitit të parë të qytetimit të saj në dy institucione kulturore e akademike në funksionin e Vlorës, përkatësisht në Bibliotekën shkencore "Nermin Vlora Falaski" të Universitetit "Ismail Qemali" si dhe Bibliotekën qytetëse "Petro Marko".